



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:151352
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05481490

Ac.nr.3522/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari individual Ylber Shurdhiqi, në çështjen përmbartimore të kreditorit A.I.A nga Irzniqi, Komuna Deçan, të cilin e përfaqëson V.K avokat nga Peja ndaj debitorit N.T.SH.T.P. “G.A”, me seli në Deçan, të cilin e përfaqëson S.B avokat nga Peja, me objekt të përmbartimit kërkesë në të holla, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të debitorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Deçan, Ep.nr.2021:151353, të datës 26.12.2021, me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të autorizuarit të debitorit N.T.SH.T.P. “G. A”, me seli në Deçan, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë–Dega në Deçan, Ep.nr.2021:151353 të datës 26.12.2021 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Deçan, me aktvendimin e ankimuar, Ep.nr.2021:151353 të datës 26.12.2021, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimi e debitori N.T.SH.T.P. “G A”, nga Deçani ndaj kreditorit A.I.A nga Izniqi, Komuna Deçan, i paraqitur kundër urdhrin për përmbartim të përmbartuesit privat P.nr. 152/21 të dt. 07.05.2021. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbartuesit Privat P.nr.152/2021 të datës 07.05.2021. Në pikën III (me aktvendim përmirësues të datës 05.04.2022) ka vendosur se ankesa e ushtruar kundër këtij vendimi nuk e ndalon procedurën përmbartimore përveç nëse është dhënë garancia bankare për shumën e plotë të borxhit sipas nenit 78 të LPP-së.

Kundër këtij aktvendimi në afatit ligjor debitori ka paraqitur ankesë dhe ankesë plotësuese, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të LPP-së dhe dispozitave të Ligjit për Noterisë, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj në tërësi ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktvendimin e shkallës së parë dhe ta anuloj urdhrin e përmbartuesit privat ashtu që ta refuzoj propozimin e

debitorit për lejimin e përbarimit apo lëndën ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë, ka paraqitur kreditori me ç'rast i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të debitorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208, 209 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori A. (I) A nga fshati Irzniq, Komuna Deçan me datë 07.05.2021 ka paraqitur propozim për përbarim kundër debitorit N.T.Sh.T.P "GOGAJ" AG me seli në Deçan në bazë të dokumentit të besueshëm Kontrata nr.8293 e datës 04.04.2016 për pagesën e borxhit në vlerë prej 1,296.20 euro, ndërsa Përbaruesi Privat Sh. A. me urdhrin përbarimor P.nr.152/21 të datës 07.05.2021 ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Kundër urdhrin të Përbaruesit Privat P.nr.152/21 të datës 07.05.2021, prapësim brenda afatit ligjor ka paraqitur i autorizuari i debitorit duke theksuar se përbaruesi privat me rastin e lëshimit të urdhrin përbarimor ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, respektivisht nenit 22.1.1.3 sepse sipas kësaj dispozite parashihet se dokument përbarues paraqet edhe dokumenti noterial i përbarueshëm sipas ligjit për noterinë, ndërsa në rastin konkret kontrata nr.8293 e datës 04.04.2016, nuk paraqet dokument përbarues në kuptim të dispozitës së nenit 22.1.1.3 të LPP-së. Më tej debitori ka theksuar se nuk qëndrojnë si të bazuara kërkesat e kreditorit për faktin se debitori të gjitha kërkesat sipas kontratës së datës 04.04.2016 i ka përmbushur ndaj Komunës së Deçanit ashtu edhe ndaj personave të tretë fizik.

Kreditori përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur përgjigje në prapësim në të cilin mes tjerash ka theksuar se pretendimet e cekura në prapësim nga ana e debitorit nuk përbëjnë asnjërën nga shkaqet e nenit 70 të LPP-së për çka mund të ushtrohet përbarimi andaj pretendimet e tilla janë irelevante. Më tej, ka theksuar se çka është dokument përbarimor e çka jo rregullohet me nenin 29.1.1.4 të LPP-së. Ka shtuar se dokumenti në bazë të cilës është lëshuar urdhri përbarimor paraqet dokument të besueshëm pasi është verifikuar nga ana e organit publik kompetent. Tutje ka theksuar se sa i përket dokumentit të bashkëngjitur nga ana e debitorit lidhur me përmbushjen e obligimeve të debitorit ndaj Komunës së Deçanit, të njëjtat nuk janë objekt kontesti ndërmjet kreditorit dhe debitorit, pasi debitori me kreditorin ka tjetër kontratë me nr.8293 të datës 04.04.2016.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimit, përgjigjes në prapësim, me aktvendimin Ep.nr.2021:151353 të datës 26.12.2021 ka refuzuar të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më saktësisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se sas shikimit dhe analizimit të dokumentit të besueshëm kontratës me nr. 8293 të dt.04.04.2016, gjykata ka gjetur se prapësimi është i pabazuar dhe e ka refuzuar si të tillë, duke e lënë ne fuqi urdhrin për përmbartim të përmbartuesit privat P.nr. 152/2021 te dt. 07.05.2021. Më tej, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka analizuar dokumentin e besueshëm kontratës me nr. 8293 të dt.04.04.2016 dhe ka konstatuar se debitori nuk i ka kryer obligimet e tij ndaj kreditorit, andaj gjykata i ka falur besimin kësaj kontrate dhe e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë, ju ka referuar neneve 29 dhe 73 të LPP-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, nuk e përkrah Gjykata e Apelit e Kosovës, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës, si dhe ankesën e palës ankuese ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale për të cilën gjykata e shkallës së dytë çdo herë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK dhe e cila shkelje sipas vlerësimit të kësaj gjykate ka ardhur si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu kjo gjykatë ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, si dhe lidhur me nenin 17, 21, 29 dhe 73 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, për çka u deshtë që ky aktvendim të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Aktvendimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse dispozitivi i aktvendimit është në kundërtënie me arsyet e aktvendimit dhe për faktet vendimtare, aktvendimi nuk përmban arsye për mënyrën e vendosjes. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbartur dispozitave të cituara për arsyetimin e aktvendimit sepse nuk ka paraqitur në mënyrë të strukturuar dhe të kuptueshme cilat kanë qenë kërkesat e palëve respektivisht kundërshtimet, cilat kanë qenë faktet vendimtare, cilat prova janë shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe si janë vlerësuar ato dhe si pasojë ka dështuar të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë ka theksuar se “ka analizuar dokumentin e besueshëm kontratës me nr. 8293 të dt.04.04.2016 dhe ka konstatuar se debitori nuk i ka kryer obligimet e tij ndaj kreditorit”, mirëpo gjykata e shkallës së parë nuk ka sqaruar se si ka ardhur deri të ky konstatim dhe cilat prova i ka shfrytëzuar se debitori nuk i ka kryer detyrimet ndaj kreditorit, andaj ky qëndrim i gjykatës së shkallës së parë paraqet shkelje të dispozitave të sipërcituara dhe për pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë.

Në ri procedurë, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që t'i ketë parasysh shkeljet e cekura si më lartë dhe që për evitimin e tyre të ndërmerr veprime përkatëse të nevojshme përmes të cilave do ta sqaroj dhe vlerësoj urdhrin përmbartimor, në kuptim të nenit 29 të LPP-së, përshtatshmërinë e urdhrin me dokumentin përmbartimor, dhe duke ndërmarrë veprime procedurale gjegjëse, ku pastaj në fund do të ketë mundësi që të merr një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në nenin 3 paragraf 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3522/22, me datë 20.03.2024

G j y q t a r i,
Ylber Shurdhiqi